



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2605/14 Prot.

Tiranë, më 30.10.2025

V E N D I M

Nr. 60 Datë 30.10 2025

**“PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS TIP PËR DHËNIEN E LABORATORËVE TË
REHABILITIMIT SI SHËRBIME PËR TË TRETË NË UNIVERSITETIN E
SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3, neni 49, neni 109, në Vendimin Nr. 57, datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UST neni 7, pika 3 dhe neni 43, 102, në Vendimin e Rektoratit nr.107 datë 06.10.2025 "Për miratimin e dhënies së laboratorëve të rehabilitimit si shërbime për të tretët në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin e Senatit Akademik nr.120 datë 20.10.2025 "Për miratimin e dhënies së laboratorëve të rehabilitimit si shërbime për të tretët në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 53 datë 22.10.2025 si dhe në Shkresën e Drejtorisë Juridike dhe të Zhvillimit të Kurrikulave nr 2614 prot dt 29.10.2025 "Kthim Përgjigje shkresës nr 2536/2 prot datë 22.10.2025 të BA", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 30.10.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e kontratës tip për dhënien e laboratorëve të rehabilitimit si shërbime për të tretë në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas formatit bashkëlidhur;
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2025

KONTRATË PËR DHËNIEN E LABORATORËVE TË REHABILITIMIT NË UST
SI SHËRBIME PËR TË TRETËT

E lidhur sot, në datën _____, në Tiranë, ndërmjet:

Palët kontraktuese:

1. Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST), me adresë Rruga “Muhamet Gjollesha”, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori (emër, mbiemër), në vijim “UST”;
2. (Emri, atësia, mbiemri) _____, lindur më _____, banues në (adresa) _____, me nr. identifikimi personal (NRP) _____, në vijim “Subjekti përfitues”.

Palët në kontratë bien dakord si më poshtë:

Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në mbështetje të:

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;

Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, neni 49, neni 109;

Vendimit Nr. 57, datë 29.01.2020 *“Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë”*;

Statutit të UST, neni 7, pika 3 dhe neni 20, 43, 102;

Vendimit të Rektoratit nr.107 datë 06.10.2025 *“Për miratimin e dhënies së laboratorëve të rehabilitimit si shërbime për të tretët në Universitetin e Sporteve të Tiranës”*;

Venimit të Senatit Akademik nr.120 datë 20.10.2025 *“Për miratimin e dhënies së laboratorëve të rehabilitimit si shërbime për të tretët në Universitetin e Sporteve të Tiranës”*;

Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 53 datë 22.10.2025 *“Për miratimin e dhënies së laboratorëve të rehabilitimit si shërbime për të tretët në Universitetin e Sporteve të Tiranës”*;

Relacion i Administratorit, shkresa me nr.2453 prot., datë 13.10.2025 *“Mbi miratimin e dhënies së laboratorëve të rehabilitimit si shërbime për të tretët në Universitetin e Sporteve të Tiranës”*;

Neni 1 - Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia e tre laboratorëve të rehabilitimit të UST si shërbime për persona të tretë, në përputhje me rregullat e brendshme të UST dhe këtë kontratë.

Neni 2 - Përshkrimi i shërbimit

UST vë në dispozicion si shërbime për persona të tretë, laboratorët e mëposhtëm:

Laboratori i Rehabilitimit,

Laboratori Tika,

Laboratori i Analizës së të Ecurit,

Pajisjet, oraret dhe mënyra e përdorimit përcaktohen në Ankesën 1 të kësaj kontrate.

Aktivitetet do të zhvillohen vetëm nën mbikëqyrjen e një personi përgjegjës nga UST.

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kjo kontratë ka afat nga data / /2025 deri më / /____, me mundësi rinovimi me marrëveshje të re me shkrim midis palëve.

Neni 4 – Pagesa dhe mënyra e likuidimit

1. Subjekti paguan ndaj UST një tarifë përdorimi prej _____ lekë/ditë ose _____ lekë/muaj, sipas Aneksit nr.1
2. Pagesat kryhen në llogarinë bankare të UST, brenda ____ ditëve nga data e faturimit.
3. Në rast vonese në pagesë, Subjekti detyrohet të paguajë interes vonese 0.1% për çdo ditë vonesë, deri në kryerjen e plotë të detyrimit.
4. Të ardhurat nga kjo kontratë evidentohen si të ardhura dytësore të UST, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.

Neni 5 – Detyrimet e palëve

UST detyrohet që:

1. Të sigurojë kushtet teknike të laboratorëve;
2. Të sigurojë kushtet higjienike-sanitare të laboratorëve , gjatë kohës së mësimdhënies;

2. Të garantojë mbikëqyrjen shkencore dhe profesionale të proceseve;
3. Të respektojë oraret dhe termat e përcaktuara në marrëveshje.

Subjekti detyrohet që:

1. Të përdorë ambientet vetëm për qëllimet e kësaj kontrate dhe gjatë orarit të përcaktuar në Aneksin 1 të saj;
2. Të sigurojë kushtet higjienike-sanitare të laboratorëve, pas orarit të mësimdhënies;
3. Të mos dëmtojë pajisjet dhe infrastrukturën;
4. Të mos modifikojë, zhvendosë ose dëmtojë asnjë pajisje, mobilim apo infrastrukturë pa autorizim me shkrim nga UST;
6. Të respektojë rregulloret e brendshme të UST-së dhe çdo udhëzim të personelit mbikëqyrës;
7. Të mbajë përgjegjësi për çdo dëm që i shkaktohet personave të tretë gjatë ofrimit të shërbimit.

Neni 6 – Përgjegjësia dhe garancia

Palët mbajnë përgjegjësi sipas ligjit për çdo shkelje të kushteve të kësaj kontrate.

Subjekti Përfitues mban përgjegjësi të plotë civile, materiale dhe penale për çdo dëm të shkaktuar pajisjeve, personelit ose personave të tretë gjatë përdorimit të laboratorëve.

UST ka të drejtë të kërkojë garanci financiare (në formë depozite ose sigurimi) për mbulimin e mundshëm të dëmeve, përpara hyrjes në fuqi të kontratës.

Në rast dëmi, UST ka të drejtë të mbajë garancinë dhe/ose të kërkojë dëmshpërblim shtesë sipas vlerës reale të demit, të konstatuar nga komisioni përkatës teknik.

Neni 7 - Konfidencialiteti

Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, rezultateve të testeve apo të dhënave personale të individëve që përfshihen në shërbime.

Shkelja e këtij detyrimi sjell përgjegjësi kontraktuale dhe ligjore sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe pronësisë intelektuale.

Neni 8 - Ndërprerja e kontratës

Kontrata mund të ndërpritet:

Me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim;

Nga UST, në rast të shkeljes së kushteve të saj nga Subjekti;

Nga Subjekti, në rast të shkeljes së kushteve të saj nga UST;

Nga UST, nëse konstatohet se aktivitetet dëmtojnë imazhin, misionin apo interesat akademike të institucionit;

Për arsye të forcës madhore ose me vendim të organeve drejtuese të UST-së.

Në çdo rast ndërprerjeje për shkak të shkeljeve të Subjektit, tarifat e parapaguara nuk rimbursohen.

Neni 9 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo kontratë do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet palëve. Nëse kjo nuk është e mundur, mosmarrëveshja i nënshtrohet juridiksionit të gjykatave të rrethit gjyqësor Tiranë.

Neni 10 – Dispozita të fundit

Çdo ndryshim në këtë kontratë bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim të palëve.

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dy palët.

Kontrata përbëhet nga ____ faqe dhe ka ____ anekse, që janë pjesë përbërëse e saj.

Nënshkruhet në dy kopje me vlerë të barabartë ligjore.

Për Universitetin e Sporteve të Tiranës

Për Subjektin Përfitues

(Administratori)

(Emri, Funkcioni)

Data: ____ / ____ / 2025

Data: ____ / ____ / 2025

DRAFT- ANEKSI NR. 1

PËR PËRDORIMIN E LABORATORËVE TË REHABILITIMIT NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Ky Aneks është pjesë përbërëse e Kontratës për dhënien e laboratorëve të rehabilitimit si shërbime për të tretët, të lidhur ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST) dhe Subjektit Përfitues, dhe ka të njëjtën fuqi ligjore me të.

1. Lista e laboratorëve të përfshirë

Nr.	Emërtimi i laboratorit	Vendndodhja	Përshkrimi i shërbimeve të mundshme
1.	Laboratori i Rehabilitimit		
2.	Laboratori “TIKA”		
3.	Laboratori i Analizës së të Ecurit		

2. Orari i përdorimit

Kategoria	Ditët e lejuara	Orari	Kufizime
Subjekt përfitues (jashtë mësimdhënies)		E hënë – E premte	ora: (Vetëm pas përfundimit të procesit mësimor.)
Fundjavë:	E shtunë ora:		

Çdo ndryshim i orarit miratohet me autorizim me shkrim nga administratori i UST-sw.

Përdorimi jashtë këtyre orareve pa leje shkakton penalitet 50% të tarifës ditore.

3. Tarifat e përdorimit

Laboratori	Tarifë ditore (lekë)	Tarifë mujore (lekë)	Vërejtje
------------	----------------------	----------------------	----------

Shënim: Tarifat përditësohen çdo vit akademik me vendim të Bordit të Administrimit të UST-sw.

4. Personeli përgjegjës i UST

Emri dhe mbiemri	Funksioni	Përgjegjës për	Kontakti
Përgjegjës laboratorësh rehabilitimi	Monitorimin teknik dhe profesional të aktiviteteve		
Specialist i sigurisë	Zbatimin e masave të sigurisë dhe mirëmbajtjes		
Punonjës administrativ	Evidencën e orareve dhe faturimin e shërbimeve		

Personeli i mësipërm ka të drejtë të ndërpresë menjëherë aktivitetin në rast rreziku, dëmtimi të pajisjeve, ose shkeljeje të rregullave.

5. Rregulla të detyrueshme të përdorimit

Subjekti Përfitues detyrohet:

- Të respektojë rregulloren e brendshme të laboratorëve dhe udhëzimet e stafit të UST-sw;
- Të përdorë pajisjet vetëm sipas destinacionit të tyre dhe në prani të personelit të UST-sw;
- Të sigurojë mbulim financiar për çdo dëm material ose shëndetësor që mund të ndodhë gjatë përdorimit.

Të ndalojë rreptësisht:

- hyrjen e personave të paautorizuar;
- përdorimin e substancave të ndaluara;
- regjistrimet apo publikimet pa leje nga UST.
- Të raportojë menjëherë çdo incident ose dëmtim në pajisje.

6. Penalitete

Shkelja e rregullave të sigurisë: gjobë deri nëlekë dhe pezullim i menjëhershëm i përdorimit.

Dëmtimi i pajisjeve: dëmshpërblim 100% i vlerës së përcaktuar nga komisioni teknik + 20% penalitet administrativ.

7. Mbikëqyrja dhe raportimi

UST mban regjistër ditor përdorimi, ku regjistrohen datat, orët dhe nënshkrimi i personelit përgjegjës.

Në fund të çdo muaji, përgatitet një raport teknik dhe financiar i shërbimeve të ofruara.

Çdo mospërputhje në raportim përbën shkelje kontrate dhe sjell penalitete për subjektin.

8. Dispozita të fundit

Ky Aneks hyn në fuqi njëkohësisht me kontratën dhe është pjesë përbërëse e saj.

Çdo ndryshim i këtij Aneksi kërkon miratim paraprak me shkrim nga Administratori i UST-sw dhe përditësim në dosjen financiare.

Për Universitetin e Sporteve të Tiranës

(Administratori)

Data: ____ / ____ / 2025

Për Subjektin Përfitues

(Emri, Funkcioni)

Data: ____ / ____ / 2025